



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

PROCESVERBAL

Mbajtur më 04 nëntor 2019, në mbledhjen e pestë (5) të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 10.00

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm: z. Bekim Zogiani, Komandant i Stacionit të Policisë; z. Osman Kurtolli, përfaqësues i Këshillit të Bashkësisë Islame; z. Enver Rama, përfaqësues i komunitetit rom; znj. Albina Avdiu, kryesuese e komitetit për Komunitete; znj. Naime Podvorica, zyrtare për Barazi Gjinore; z. Agim Blakçori, drejtor i Drejtorisë së Arsimit; z. Naim Bajraktari, kapiten, përfaqësues i FSK-së; z. Qefser Behrami, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike-Kërpimëh; z. Nuhi Selimi, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike-Orllan; z. Rizah Muçolli, kryesues i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi, z. Faik Muçiqi, përfaqësues i emergjencave civile; z. Liman Zeqiri, përfaqësues i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe znj. Donjetë Sheqiri, përfaqësuese e OJQ-ve, mediave lokale, komunitetit të biznesit dhe komunitetit të personave me nevoja të veçanta.

Ndërsa mungoi: dhe z. Radisav Perović, përfaqësues i Komunitetit serb.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe: Përfaqësuesi i KFOR-it; z. Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës, z. Durim Salihu, Drejtor i Drejtorisë Inspeksionit, znj. Maja Lehner dhe z. Skender Shatri – OSBE.

z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, mirë se keni ardhur, më lejoni të hap mbledhjen e KKS-së, besoj se Thirrjen dhe materialin e nevojshëm për mbledhje e keni marrë me kohë, a ka ndonjë vërejtje apo plotësim lidhur me rendin e ditës.

Rendi i Ditës
U miratua njëzëri.

- 1. Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 26 shtator 2019**
U miratua njëzëri
- 2. Raporti i Policisë së Kosovës për gjendjen e sigurisë në komunë**
 - Informatë nga përfaqësuesi i KFOR-i për sigurinë në komunë
 - Informatë nga përfaqësuesi i FSK-së për sigurinë në komunë

z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, fillimisht fjalën e ka Komandanti i Stacionit të Policisë, pastaj vazhdojmë me informatat që do të japin përfaqësuesi i KFOR-it dhe ai i FSK-së.

z. Bekim Zogiani, theksoi, situata e gjendjes së sigurisë vlerësohet e qetë dhe stabile, nuk ka ndonjë informacion apo indikacion të mundshëm për prishje së rendit dhe qetësisë publike në përmasa të mëdha. Gjatë kësaj periudhe raportuese i kemi të evidentuara gjithsejtë 85 raste të ndryshme. Si çështje më shqetësuese gjatë muajit tetor ka qenë dukuria e shfaqjes së zjarreve në një numër bukur të madh. Dje gjatë ditës ka qenë një zjarr në fshatin Metehi ku ka intervenuar Shërbimi i Zjarrfikësve por edhe Policia. Kërkoj nga të gjithë që të përkujdesemi për ruajtjen e kësaj pasurie. Nga të dhënat dhe informatat e grumbulluar rezulton se faktori njeri është shkaktari kryesor i këtyre zjarreve.

z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, falënderojmë Komandantin për raportin, fjalën e ka përfaqësuesi i KFOR-it, pastaj ai i FSK-së.

Përfaqësuesi i KFOR-it, theksoi, nga ana e KFOR-it nuk ka asgjë për të raportuar.

z. Naim Bajraktari, theksoi, ne si FSK, përgjithësisht vlerësojmë se situata është e qetë dhe stabile gjatë muajve të kaluar dhe një gjendje e tillë vazhdon. Sa i përket aktiviteteve, nuk ka pas ndonjë që ka të bëjë me Komunën tonë.

z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, e hap diskutimin për këtë pikë.

Nëse nuk ka dikush diçka rreth kësaj pike, e përmbylлим me konstatimin që gjendja e sigurisë në Komunë është e qetë dhe stabile dhe nuk ka ndonjë indikacion për prishje të rendit dhe qetësisë publike.

3. Informatë për sigurinë në shkolla dhe masat për ngritjen e sigurisë

z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, fjalën e ka Drejtori i Drejtorisë së Arsimit z. Agim Blakçori.

Kryetari për shkak të angazhimeve autorizoi Nënkryetarin e Komunës z. Nexhmi Rudari për vazhdimin e mbledhjes.

z. Agim Blakçori, theksoi duke u bazuar në raportet e Policisë së Kosovës, raportet e shkollave dhe të DKA-së mund të themi se gjendja e sigurisë në shkolla në Komunën e Podujevës është e qetë dhe stabile, konstatim të cilin e përforcon mbarëvajtja e tërë procesit mësimor në të gjitha nivelet e arsimit në Komunën e Podujevës. DKA në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë akterët përgjegjës për mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe për ruajtjen e sigurisë kanë bërë të gjitha përgatitjet me kohë dhe kanë marrë masat e nevojshme për të siguruar një mjedis të qetë dhe të sigurt në të gjitha institucionet edukative arsimore. Gjatë këtij viti në Komunën e Podujevës janë zhvilluar disa projekte në ndërtimin e infrastrukturës shkollore, siç janë: përfundimi i punimeve në ndërtimin e objektit të shkollës “Dituria” Llapashticë e Poshtme; punimet në ndërtimin e shkollës “Emin Duraku”, në fazën përfundimtare; etj. Drejtori informoi edhe për punët në përmirësimin e infrastrukturës në disa objekte shkollore, pastaj për instalimin e kamerave në disa prej shkollave me numër më të madh të nxënësve, për sigurimin e transportit të nxënësve që kanë distancë mbi 4 km nga shtëpia në shkollë, si dhe për fëmijët me nevoja të veçanta, në gjithë territorin e Komunës së Podujevës, pastaj për projektin e Dezinfektimit, Dezinsektimit dhe Deratizimit(DDD), në të gjitha objektet shkollore. Drejtori gjithashtu foli për organizimin e garave shkollore komunale në futboll dhe volejbol, pastaj për ndërtimin dhe rregullimin e trotuareve në drejtim të shkollave. Nënvizoi, në këtë rast do kërkoja nga Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit që gjatë planifikimeve për ndërtimin e trotuareve të vazhdojë t’u jep përparësi rrugëve që shpijnë për në shkolla. Ndër të tjera foli edhe për rolin e organeve qeverisëse –

udhëheqëse dhe profesionale të shkollës në zhvillimin dhe ngritjen e cilësisë në arsim por edhe për sigurimin e një mjedisi të sigurt në shkolla. Nënvizoi, sa i përket bashkëpunimit DKA nga Policia e Kosovës ka mbështetje të vazhdueshme në të gjitha aktivitetet ku është e nevojshme, si (organizimi i garave, testeve, mbrëmjeve, shëtitjeve e ekskursioneve etj.) gjatë periudhës 2018/2019.

Gjithashtu kemi zhvilluar edhe takime të drejtpërdrejta me Komandantin e Stacionit të Policisë së Podujevës, por edhe me zyrtarë tjerë, ku i kemi bashkërenduar veprimet dhe aktivitetet e ndryshme, me qëllim që të jemi më efikas në kryerjen e punëve, detyrave dhe përgjegjësiave tona.

Policia e Kosovës në bashkëpunim me DKA dhe shkollat kanë organizuar ligjërata me nxënës, me karakter informues dhe sensibilizues mbi dukuritë e ndryshme negative etj.

Si kërkesë për policinë që të vazhdohet me patrullime të rregullta në afërsi të shkollave edhe gjatë vitit shkollor 2019/2020, sidomos te shkollat e mesme të larta.

Presim që ky bashkëpunim në mes DKA dhe Policisë të vazhdojë edhe më tutje, në mënyrë që të sigurojmë një mjedis të qetë dhe të sigurt për të gjithë komunitetin shkollor.

Drejtori si sfida përmendi disa çështje, siç janë: Dëmtimet në objektet e disa shkolla nga persona të panjohur pas përfundimit të orarit mësimor, mungesa e rojës në të gjitha shkollat, incidentet dhe zënkat ndërmjet nxënësve, bartja e mjeteve të palejueshme nga disa nxënës, lokalet afër shkollave (shitja e cigareve), funksionalizimi i shërbimit pedagogjik-psikologjik në të gjitha shkollat, qentë endacak, komunikacioni (mungesa e pengesave në rrugët afër shkollave, parkingu i veturave në trotuare etj.). Mbesim të përkushtuar që të përmirësojmë kushtet për punë dhe mësim dhe për të krijuar një mjedis më të qetë dhe më të sigurt.

z. Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës, e hap debatin lidhur me këtë pikë.

z. Bekim Zogiani, sa i përket bashkëpunimit të Policisë me Drejtorinë e Arsimit mund të them se kemi një bashkëpunim shumë të afërt, mirëpo janë disa çështje që duhet të trajtohen dhe për të cilat ndjejmë shqetësim. Javën e kaluar kemi arrestuar tre nxënës, njëri ka pas një armë, ndërsa dy të tjerë thika. Kërkoj nga drejtori i DA dhe nga të gjithë drejtorët e shkollave që kontrollet e nxënësve të jenë më të shpeshta dhe ne jemi të gatshëm t'i përkrahim në mënyrë që mos të kemi ndonjë rast të lëndimeve apo me fatalitet. Sa i përket çështjeve të tjera si ligjëratat për dhunën në familje që janë mbajtur nëpër shkolla, janë mirëpritur nga niveli arsimor por edhe nga nxënësit. Planifikojmë të mbajmë edhe ligjërata tjera në fushën e sigurisë duke bashkërenduar dhe koordinuar veprimet me Drejtorin e DKA-së.

z. Qefser Behrami, theksoi, disa persona ndoshta të pa vetëdijesuar dhe të pakulturuar herë pas herë janë duke penguar procesin mësimor në shkollën e fshatit Kërpimeh duke bërë vozitje me një motor shumë të zhurmshëm. Për këtë kam njoftuar Komandantin e Policisë për çka i jam shumë mirënjohës për punën dhe angazhimin e tij.

Kam një vërejtje të vogël edhe sa i përket instalimeve të kamerave nëpër shkolla, drejtori i DKA-së i përmendi disa prej tyre por jo edhe shkollën e fshatit Kërpimeh ku kemi vendosur sistemin e kamerave duke ju falënderuar OSBE-së, natyrisht në bashkëpunim me Komunën dhe Ambasadën Norvegjeze. Do të mundohem që prej OSBE-së këtë projekt ta zgjeroj edhe në disa shkolla tjera, por ndoshta edhe digjitalizimin me kamera në pjesën e rrezikshmërisë në fshatin Kërpimeh. Sa i përket shkollës kemi një situatë të mirë.

z. Faik Muçiqi, do të lidhem me çështjen e sigurisë afër shkollave. Nuk jam në dijeni se sa ka informacione, por veçanërisht te shkollat e mesme, në orët e vona jashtë objekteve shkollore po ka pengesa të cilat po ndikojnë në mbarëvajtjen e mësimi, shqetësim të cilin e kanë paraqitur profesorët e shkollave. Cilat janë masat e Policisë në këtë drejtim.

z. Bekim Zogiani, theksoi, sipas planit operativ të gjitha shkollat janë të mbuluara me njësi policore, me pika kontrolli dhe patrullim afër shkollave, dua të theksoj veçanërisht pran shkollës ekonomike “Isa Boletini” dhe te gjimnazi “Aleksandër Xhuvani”, fjala është gjatë orëve të vona, ndërsa gjatë ditës deri në ora 16:00 eventualisht në ora 18:00 ka mbikëqyrje të vazhdueshme nga Policia. Përkushtimi i Policisë në ofrimin e sigurisë nëpër shkolla është në nivelin maksimal, mirëpo duhet pasur parasysh se paraqiten edhe raste të tjera për të intervenuar, e që duhet të tërhiqet Policia për një kohë të shkurtër, mirëpo siç e theksova e kanë në plan dhe janë të fokusuar të jenë në afërsi të shkollave.

z. Qefser Behrami, po flas në cilësi të përfaqësuesit të komunitetit të pjesës veriore të Komunës së Podujevës. Me ndryshimin e orës së procesit mësimor prej 45 min. që na është kumtuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, ne i kemi bërë një kërkesë DKA-së që të na konfirmojë me shkrim lidhur me orarin. Ne si shkollë e fshatit Kërpimëh kemi ankesa nga prindërit e nxënësve për zgjatje të kohës së orës mësimore. Në pjesën tonë kemi nxënës që udhëtojnë edhe mbi 4 km dhe nuk ka transport të siguruar për këta nxënës, e që ka rrezikshmëri të madhe edhe nga qentë endacak por edhe nga shtazët egra. Pra kjo është arsyeja e shqetësimit dhe jemi në pritje që kjo të na konfirmohet në formë të shkruar.

z. Agim Blakçori, mendoj se rreth orarit dhe kohës mësimore nuk kemi se çka të bisedojmë sepse kemi një vendim nga Ministri i MASHT-it, e gjithashtu është edhe obligim ligjor që kohëzgjatja e orës mësimore të jetë prej 45 min. Sa i përket largësisë së shkollës e përmenda edhe në informatë se të gjithë nxënësve që kanë një distancë prej më shumë se 4 km nga shkolla i është siguruar transporti. Nëse ka ndonjë nxënës që nuk e ka të siguruar transportin, atëherë Drejtori ta paraqet në kërkesë në mënyrë që t'i sigurojmë transport.

z. Nexhmi Rudari, Nënkretar i Komunës, theksoi, drejtori i DKA-së paraqiti një informatë lidhur me gjendjen e sigurisë në institucionet arsimore. Mendoj që çështja e sigurisë më së tepërmi ka të bëjë me shkëmbim të informacionit, sa të shpejta janë reagimet tona në shkëmbimin e informacionit mes institucioneve, në këtë rast shkollat me DKA-në dhe DKA në rastet kur e vlerëson me Policinë. Do të ishte mirë që të kemi një politikë proaktive që do të ishte parandaluese. Është vërtetë për keqardhje që Policia konfiskon një armë të zjarrit dhe dy armë të ftohta në afërsi të shkollës. Pra qëllimi i atyre personave qofshin nxënës apo të tjerë është shumë i qartë dhe kjo është shumë shqetësuese. Në këtë rast përgjegjësinë kryesore e bartin Drejtorët e shkollave së bashku me kujdestarët e klasës. Duhet të jemi shumë më vigjilentë, e kam theksuar edhe në një takim tjetër, siguria në shkollë përmirësohet me vendosjen e kamerave por nuk sigurohet, Drejtorët e shkollave nuk duhet të qëndrojnë në zyrë dhe të monitorojnë situatën përmes monitorëve, por duhet të jenë të angazhuar me mekanizmat që kanë në shkollë, me kujdestarë të klasave, me këshilla të nxënësve, këshilla të prindërve, t'i kushtojnë një vëmendje më të madhe çështjes së sigurisë. Jam në dijeni se ka raste ku Drejtorët e shkollave i fshehin problemet me qëllim që shkolla mos t'u dal keq për nga performanca, mirëpo nëse problemi fshehët ai vjen duke u rritur. Në rast se ndonjë Drejtor i shkollës ka informacione për ndonjë mosmarrëveshje mes nxënësve dhe nuk ndërmerr masa, ato mund të kalojnë me pasoja të rënda. Kërkohet nga Drejtorët e shkollave të vërejnë me kohë mundësitë e një konflikti që do mund të ishte fatal. Dua të përmend edhe çështjen e trotuareve afër shkollave, ku është bërë një punë e mirë por ende ka nevojë që të ndërtohen. Kemi po ashtu vërejtje nga prindërit për zënien e trotuareve në qytet. Shumica e trotuareve në qytet janë të uzurpuara nga automjete të ndryshme motorike, por edhe me dru për djegie, zall dhe material ndërtimor. Nuk po i përjashtoj përgjegjësitë tona të Komunës si inspeksion por edhe të Policisë që duhet të kenë një çasje shumë më

proaktive. Trotualet nuk janë të ndërtuar për vetura. Problemi është aq i madh sa do të kemi problem për t'i liru për njëherë, andaj kërkoj nga Inspeksioni por edhe nga Policia të angazhohen më shumë për lirim e trotualet. Nëse nuk keni diçka rreth kësaj pike, e përmbyll dhe kalojmë në pikën e radhës.

4. Informatë për sigurinë në komunikacion

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, fillimisht fjalën e ka Komandanti Stacionit të Policisë z. Bekim Zogiani, e pastaj Drejtori i Drejtorisë së Inspeksionit z. Durim Salihu.

z. Bekim Zogiani, sa i përket sigurisë në komunikacion në Komunën e Podujevës në përgjithësi mund të vlerësojmë se gjatë muajit tetor, periudhës së raportimit, kemi pasur 10 aksidente të komunikacionit, krahasuar me periudhën e njëjtë të viti të kaluar ku kemi pasur 15 aksidente, pra me 41 % rënie. Në periudhën tetor 2019 janë shqiptuar 850 gjoba të trafikut, ku një numër bukur i madh i tyre janë për parkime jo të rregullta, që krahasuar me periudhën e njëjtë 2018 kanë qenë 449, d.m.th. 89% kemi të shqiptuara më shumë. Gjatë periudhës janar–tetor 2018 kanë qenë 4712 gjoba të shqiptuara, ndërsa në periudhën e njëjtë të këtij viti 5589 d.m.th. 18% ngritje. Sa i përket aksidentëve në trafik krahasuar me periudhat kohore, i kemi 148 aksidente në vitin 2018 dhe 150 në vitin 2019. Persona të lënduar kanë qenë 22 në vitin 2018, ndërsa në 38 në vitin 2019 gjatë periudhës janar-tetor, etj. Në përgjithësi jemi duke dhënë maksimumin sidomos tani edhe me angazhimin e policëve të rinj dhe qytetin e kemi në prioritet.

z. Durim Salihu, theksoi, kemi përgatitur një raport janar-shtator 2019. Bazuar në kompetencat dhe obligimet ligjore që ka Drejtoria e inspeksionit, konkretisht sektori për komunikacion një prej prioriteteve tona në bazë të planit të punës, kërkesave të qytetarëve dhe bashkëpunimit me Policinë e Kosovës në terren prioritet i kemi dhënë mbarëvajtjes dhe kontrollimit të të gjitha lejeve që janë pajisur qofshin personat fizik qoftë juridik. Fokusi ynë ka qenë mbarëvajtja e orarit, siguria e automjeteve që ushtrojnë transportin e udhëtarëve në përgjithësi. Kemi bërë kontrole të shitësve ambulantiv të cilët janë të lejuar rreth pajisjes së dokumentacionit për transport, kështu që në total ne i kemi bërë 796 inspektime, prej të cilave kemi shqiptuar 117 gjoba të ndryshme, kemi konfiskuar 62 automjete për shkak të parkingjeve në hapësirat e ndaluara për parking, gjithashtu kemi parashtruar 62 kërkesa për kundërvajtje në Gjykatë. Për Drejtorinë e Inspeksionit sikurse u theksua më herët shqetësuese mbetet zënia e trotualet. Me ligj është përcaktuar që bashkëpunimi për lirim e tyre duhet të jetë në mes Policisë dhe Inspeksionit. Policia sipas autorizimeve ligjore duhet të siguroj lirim e trotuarit së paku 1.6m por bashkërisht edhe me asistimin e Inspeksionit. Kohën e fundit më tepër u është dhënë prioritet gjobave se sa konfiskimit të automjeteve, por mendoj se duhet vazhduar prapë edhe me konfiskimin e automjeteve, e kam fjalën për automjetin merimangë, ajo shumë pak shihet në terren. Gjjobat janë shqiptuar ndaj parkimeve ilegale dhe shqetësim tjetër është edhe çështja e vendparkingjeve të automjeteve të udhëtarëve, konkretisht e kemi një pjesë të rrugës te rreth rrotullimi që lidhë rrugën për në fshatin Kërpimeh, gjithashtu është edhe kryqëzimi i rrugës te marketi Viva Fresh, te pjesa jugore e Komunës që lidhet me fshatrat, jemi në koordinim edhe me Drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit dhe Drejtorin e Drejtorisë Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit që të bëjmë një peron apo parking të përkohshëm në kohë prej 2-3 apo 5 minuta. Përfundoi, sikurse e theksoi edhe Komandanti gjendja ka mundësi edhe më të përmirësohet.

z. Faik Muçiqi, dua të kontribuoj në këtë pikë pasi që ndërlidhet me disa çështja, fillimisht me pajisje me leje pune për operatorët e transportit. Në fillim të vitit kemi bërë një listë të të gjithë operatorëve, janë pajisur ata që kanë pasur leje gjatë viti 2018. Gjatë viti 2019 nuk kemi pasur operatorë të rinj. Deri në vitin e ardhshëm nuk do të shpallim ndonjë konkurs për shtimin posaçërisht të autotaksëve dhe radiotaksive sepse kemi konsideruar se numri aktual është i mjaftueshëm, pavarësisht kërkesave që shumë herë paraqiten dhe shumë herë janë periodike. Vazhdimi i lejeve në vitin e kaluar është bërë në fillim të vitit, ndërsa këtë vit do ta ndryshojmë dhe do ta aplikojmë nga muaji nëntor. Do të bëjmë thirrje publike që operatorët të lajmërohen, në mënyrë që në fillim të vitit të jemi të gatshëm. Këtë herë do të kemi më shumë kontrole dhe ndaj atyre operatorëve që do të kemi vërejtje ndoshta edhe nuk do u vazhdohet leja. Kemi probleme ende me oraret, por këtë vit do të merremi edhe me këtë në mënyrë që secili operator të pajiset me orar, edhe pse ndodhë që shumë herë nuk i respektojnë, por për këtë do të merren Inspeksioni dhe Policia. Vitin e kaluar kanë qenë 12 autobus, 20 me minibus, 23 me kombi linje, tre operator të radiotaxi me leje pune dhe që u është vazhduar e njëjta, ndërsa autotaxi numri i tyre ka qenë 25. Problem tjetër është mungesa e hapësirave, Stacioni i autobusëve nuk ka një hapësirë të mjaftueshme për të gjithë operatorët. Secilit operator të transportit në leje i specifikohet se nisjen apo pikën fillestare e ka Stacionin e autobusëve, mirëpo tani për tani mundësia nuk është t'i orientojmë të gjithë në Stacion, mirëpo me fillimin e vitit një pjesë të madhe do të mund ti orientojmë. Komuna e Podujevës është njëra nga përfitueset e financuara nga GIZ për planin e mobilitetit i cili do të na ndihmojë në qytet për problemet e hapësirave publike, hapësirave për këmbësorë, çiklizmit, hapësirat e vend ndaljes-stacioneve të autobusëve. Drejtori z. Durim Salihu e përmendi se disa herë kemi bërë përpjekje që në disa stacione si në fshatrat Dumnice, Llapshticë ose pjesa nga fshati Shajkoc të kemi disa peronë për vend ndalje dhe vend marrje, por do të shikojmë me fillimin e vitit. Dua të falënderoj policinë që punojnë në komunikacion për bashkëpunim, janë shumë të kujdesshëm për identifikimin e shenjave të komunikacionit të dëmtuara, të vjedhura dhe për mungesën e tyre dhe së bashku do të vijmë edhe te një kërkesë që tani për tani është në vlerësim dhe së shpejti do të fillon edhe faza tjetër e shenjëzimeve që do të vendosen në qytet dhe fshatra të Komunës, aty ku mungojnë, ku janë dëmtuar, ku e shohim që rreziku është permanent. Prej tyre një numër do të jenë pasqyra, shenjëzime por edhe barrierat në rrugë për shkak të vozitjeve të shpejta. Do të vazhdojmë me këto barrierat edhe në fazën e dytë brenda 10 ditësh aty ku ka vlerësuar një komision i përbashkët se janë të domosdoshme dhe shenjat do të vendosen në vazhdimësi deri në fund të vitit. Kemi bërë përpjekje edhe për riparimin e rrugëve, kryesisht në qytet por edhe në periferi dhe kjo është duke vazhduar, është në fazën përfundimtare. Sa i përket trotuareve, ndërtimi i tyre vazhdon dhe atë kryesisht afër shkollave. Në rrugën Sfeçël-Shajkoc në segmentin më të rrezikshëm që kemi vlerësuar kemi ndërtuar trotuare në dy drejtimet për shkak të udhëkryqit që është jashtëzakonisht i rrezikshëm. Drejtori foli edhe për lokacionet tjera ku është duke vazhduar ndërtimi i trotuareve, ku 95% janë afër shkollave. Sa i përket ndriçimit publik, rruga më e ndjeshme nga qyteti-fshatin Peran është në fazën e përfundimit të ndriçimit, pastaj ndriçim publik do të ketë edhe në rrugën magjistrale deri në pikën doganore, do të ketë edhe në një pjesë në fshatin Orllan dhe janë 6 rrugica brenda qytetit, gjë që do të ndikojnë shumë në siguri. I përmenda disa projekte të cilat tërthorazi ndikojnë në sigurinë në komunikacion, por si çështje kyçe do të jetë pajisja me leje e të gjithë operatorëve, kontrollimi i tyre sistematik nga inspeksioni dhe policia çoftë të gjendjes së automjetit, çoftë personelit vozitës etj.

z. Durim Salihu, dua të potencoj edhe një çështje që ka të bëjë edhe çështjen e sigurisë në komunikacion, fjala është për respektimin e orareve të agjencioneve të autobusëve.

Ne i kemi bërë vërejtje edhe Nivelit qendror si Drejtori e Inspeksionit që gjatë sezonit veror agjencionet e licencuara i shmangen respektimit të orarit në linjën Podujevë-Prishtinë dhe të njëjtit më shumë janë të përkushtuar transportit për turizëm bregdetar, gjendje kjo e cila ka shkaktuar probleme të mëdha me rritjen e numrit të taksive ilegale. Ndaj taksistëve ilegale ne kemi ndërmarrë masa, ka edhe shumë raste që në bashkëveprim me Policinë kemi bërë konfiskimin e automjeteve. Ka pas shumë raste që automjetet e transportit ilegal kanë qenë të pakontrolluara teknikisht. Këto vërejtje ua kemi përcjellë edhe operatorëve në fjalë. Jemi në hartim të një plani operativ bashkërisht me Policinë për evitimin e kësaj dukurie negative, përndryshe e shoh si rrezik të atyre udhëtarëve që qarkullojnë për në Prishtinë dhe anasjelltas me vozitës ilegal.

z. Naim Bajraktari, theksoi, desha të ndalem te projekti i shenjëzimit të rrugëve, kam një propozim që mundësisht të bëhet shenjëzimi i pikës doganore Gllogovicë, te fshati Keqekollë. Shenjëzimi të fillojë që nga hyrja në pikën doganore në Merdare për shkak të fluksit të madh të bashkatdhetarëve, të cilët shpeshherë detyrohen që me taxi me një kosto të lartë për të shkuar në atë pikë doganore, sepse pjesa dërmuese e qytetarëve të Kosovës nuk kanë njohuri se ku gjendet ajo pikë.

z. Nexhmi Rudari, Nënkrjetar i Komunës, nëse nuk ka dikush diçka për të shtuar kalojmë në pikën e fundit të Rendit të ditës.

5. Të ndryshme

z. Nexhmi Rudari, Nënkrjetar i Komunës, a ka dikush diçka që të paraqes në këtë pikë, ndonjë propozim për takimin e radhës.

z. Durim Salihu, dua të paraqes një shqetësim si Drejtori që jemi por edhe të banorëve të fshatit Orllan. Javën e kaluar jemi të njoftuar edhe nga përfaqësuesi i fshatit Orllan që në një pjesë të paluajtshmërisë e quajtur Golesh, sipër Xhamisë së fshatit, e cila është pronë komunale persona të paidentifikuar kanë vendosur kontejner metalik dhe kamp shtëpiza duke shkaktuar një demë. Inspeksioni dy here ka qenë në vend të ngjarjes dhe nuk kemi hasur asnjë prej personave, ne kemi lënë procesverbalin me urdhër që te lajmërohen në Drejtorinë e Inspeksionit por nuk janë lajmëruar. Në këtë rast kisha kërkuar edhe ndihmën e policisë për identifikimin e tyre dhe t'i kontaktojmë ata persona të papërgjegjshëm për dëmtimin e asaj hapësire, të cilët kanë prerë drunjë për të krijuar hapësirë për pushimore.

z. Nuhi Selimi, theksoi, jam informuar nga banorët se në atë hapësirë me eskavator është punuar gjatë natës dhe gjatë ditëve të vikendit. Ato vikendica kanë qenë buzë liqeni, por pasi që Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinorë i largoi, të njëjtat i kanë zhvendosur në hapësirën ku jemi duke diskutuar. Ne kemi lajmëruar Policinë, por si duket aty është krijuar një dukuri që do të vazhdojë, nuk dua të prejudikoj, por të prehen drunjë/pishat të cilat janë mbjellë para 30 viteve nga nxënësit, kjo bënë për të kuptuar se ata sigurisht dikund kanë siguruar mbështetje në Qendër. Personat për të cilët është fjala nuk janë banorë të fshatit Orllan, por sigurisht persona me ndikim, çoftë nga politika, apo komandantë, në atë pjesë janë vendosur 3-4 kam shtëpiza. Banorët e fshatit kanë deklaruar se nëse organet kompetente nuk ndërmarrin masa për largimin e tyre, do të përballen vet me këtë situatë, për t'i larguar apo demoluar ato. Për të mos ardhur deri te kjo situatë kërkojmë që me këtë të merren organet kompetente, sepse në atë pjesë është shkatërruar ambienti. Pra është një problem që duhet shqyrtuar seriozisht.

z. Naim Bajraktari, nëse parafolësi ka informacione se prapa kësaj situate qëndrojnë persona nga fusha e sigurisë (komandantë) është mirë që këta të identifikohen sepse ne kemi edhe njësi përkatëse e cila merret edhe me këtë çështje, unë këtë do ta ngriti edhe në nivelin më të lartë ku do të merreshin masa të menjëhershme.

z. Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës, kjo që u theksua është shqetësim i të gjithë neve, në veçanti i institucionit, në këtë rast i Komunës, për shkak se hapësira ku janë vendosur kampshtëpizat dhe është dëmtuar ambienti është pronë komunale. Shfrytëzimi i palejuar i pronës komunale është çështje e sanksionuar. Ne duhet të marrim masa përmes inspeksionit dhe nëse hasim në pengesë/rezistencë për kryerjen e punëve tona është Policia të cilën do ta thërrasim për asistim. Nëse nuk hasim personat mund të konfiskojmë objektet e vendosura, përndryshe shprehjet komandanta apo jo komandanta nuk janë të mira, janë deklarata hipotetike, ne duhet të flasim me fakte dhe argumente. Ne po konstatojmë që kemi një kërkesë nga KLSB dhe banorët e fshatit Orllan për lirim të hapësirave publike të uzurpuara dhe reagimi ynë institucional duhet të jetë i shpejtë dhe i fuqishëm. Inspeksioni të shkojë prapë në vendngjarje dhe të qëndrojë edhe më gjatë në përpjekje të identifikimit të shfrytëzuesve/dëmtuesve ilegal të asaj hapësire dhe nëse nuk paraqiten personat të nxjerrët vendim për konfiskimin e të gjitha objekteve në ato hapësira, kjo të jetë prioritet në agjendën e Drejtorisë së Inspeksionit.

Nëse nuk ka dikush diçka për të shtuar atëherë ju falënderoj prezencën dhe kontributin.

Mbledhja përfundoi në orën 11:05

Procesverbalin e mbajti
Sabedin Namani

Nr. 02-060/04-0085766/19
Podujevë, 04 nëntor 2019

Kryetari i Komunës
Agim Veliu